



NJOFTIM PËR SHTYP

Anëtarësimi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në CEER

Në takimin e Asamblesë së Përgjithshme, të mbajtur me 17 nëntor 2015, Këshilli Evropian i Rregullatorëve të Energjisë (CEER) ka pranuar Zyrën e Rregullatorit për Energji (ZRRE) në rolin e vëzhguesit.

Aplikimi i ZRRE-së për tu anëtarësuar në këtë organizatë të rëndësishme ka ardhur pas vendimit të CEER që të ju ofrojë Anëtarëve të Palëve Kontraktuese të Traktatit të Komunitetit të Energjisë mundësinë që të marrin pjesë si Vëzhgues në punët e CEER.

ZRRE, është autoriteti kombëtar rregullator i tretë, i Komunitetit të Energjisë, që po i bashkohet CEER, pas Rregullatorit të Malit të zi dhe Republikës së Maqedonisë.

Anëtarësimi në CEER do t'i ndihmoj Kosovës në përpjekjet e saj për të aplikuar Acquis të BE-së për Energji, duke përfituar përmes bashkëpunimit rregullativ dhe shkëmbimit të praktikave më të mira të anëtarëve të CEER si dhe vëzhguesve nga e gjithë Evropa.

Në përbërjen e CEER janë 33 autoritete Rregullative nga vendet e BE-së, EFTA dhe nga vendet aspirantë të BE-së, duke përfshirë edhe ato të Komunitetit të Energjisë ku bënë pjesë edhe Kosova.